



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Numri i Çështjes	71041-00159-11-2017	Data e Regjistrimit	2/3/2017
Numri i Vendimit	11-2017-771	Data e Vendimit	2/17/2017

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:

KRYESUES: Fejzo Hysi

ANËTAR

SEKRETARE Vasilika Fuqi

Objekti: Heqjen e sekuestros preventive të vendosur me vendim nr.436/1 datë 27.07.2015 të ***** së Shkallës së Parë Durrës.

Baza Ligjore : Neni 274/3 i K.Pr.Penale.

Përmbledhja e vendimit:

Gjykata pasi administroj aktet që i bashkëngjiten fashikullit të gjykimit, dëgjoj përfaqësuesen e kërkuarit që kërkoj të pranohet kërkesa sipas objektit të saj.

Përfaqësuesin e akuzës, prokuror Afrim Shehu i cili deklaroj se ne jemi shprehur për heqjen e sekuestro preventive në vendimin e pushimit të çështjes dhe jemi për pranimin e kërkesës të kërkuarit.

Vëren:

Se! ***** e Rrethit Gjyqësor Durrës mbi bazën e referimit të kryer nga policia gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë Qarku Durrës, ka regjistruar procedimin penal nr. 237 të vitit 2010, rifilluar me datë 28.05.2012 për veprën penale "Pastrim i produkteve të veprës penale" parashikuar nga neni 287. 1, germa" a , b" të Kodit Penal.

Mbi këtë bazë prej saj është kërkuar të vendoset sekuestro preventive mbi pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të kërkuarit
***** *****

Gjykata e rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin e saj Nr.436
Datë 08.07.2015 është vendosur:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRËS

“- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

- *Vendosjen e sekuestro preventive të pasurisë së paluajtshme si më poshtë:*
- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.
- Vendosjen e masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive mbi pasuritë:
- Pasuria Nr 2/228, vol 1 8, fq 75, e ndodhur në adresë lagja nr 18, Rr "A.Goga", ku është regjistruar një apartament me sipërfaqe 65 m2, nr dok. 5349 date 08.05.2009, me vlerë 3.211.663 lekë.
- Pasuria nr 26/72-G2, vol 14, fq 222 e ndodhur në adresë në lagjen nr 13, Plazh, garazh, sipërfaqe e pasurisë 21.26 m2, dok.6682, datë 06.09.2005 vlera 1.900.000 lekë.
- Pasuria nr 26/72+110, vol 14, fq 231 me adresë në lagjen nr 13, plazh, apartament, sipërfaqe e pasurisë 106.0 m2, nr. dok. 03682, datë 09.06.2009, vlerë 1.900.000 lekë.
- Pasuria nr 27/168 NB - 47, vol 55, fq 195, në adresë lagja nr 13, plazh Durrës, sipërfaqe e pasurisë 119.2 m2, ref 010387 nr. dok 10989 datë 28.10.2008, me vlerë të pasurisë 11.997.480 lekë në emër të shtetasit Nuri Rama.”

Pala kërkuese në kërkesën drejtuar gjykatës argumenton se:

Me vendim të datës 25.11.2015 , ***** e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur , Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. 237 Viti 2012 për veprën penale të “ Pastrim të produkteve të veprës penale “ parashikuar sipas nenit 287/1 germa “ a dhe b “ të Kodit Penal në ngarkim të shtetasit ***** ***** si dhe në bazë të nenit 261/1 germa “ a” të K.Pr.Penale urdhëron heqjen e masës sigurimit “Sekuestro preventive” të vendosur ,me vendim nr. 436/ dhe 436/1 datë 08.07.2015 e datë 27.07.2015 të ***** Rrethit Gjyqësor Durrës dhe urdhëron ZVRPP Durrës për zbatimin e këtij vendimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Kërkuesi argumenton se ky vendim i marrë nga organi i akuzës nuk është zbatuar nga ZVRPPP Durrës me pretendimin se është gjykata që ka marrë vendimin e sekuestro dhe i përket po këtij institucioni të vendos heqjen ose jo të sekuestro preventive mbi këtë pasuri në emër të kërkuesit.

Gjykata pasi administroj dosjen gjyqësore me nr.436 të vendimit datë 08.07.2015 të ***** Rrethit Gjyqësor Durrës, vendimin e datës 25.11.2015 të Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës që ka vendosur pushimin e hetimeve të proçedimit penal nr. 237 viti 2012, arrin në përfundimin se kërkesa e kërkuesit është e bazuar në ligj dhe prova dhe si e tillë duhet të pranohet duke urdhëruar heqjen e sekuestro preventive pranë ZVRPP Durrës të dhënë po nga kjo gjykatë me vendimin Nr. 436 datë 08.07.2015 .

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

Gjykata bazuar në 274/3 të K.Pr.Penale .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Vendosi:

- □□□□□□□ Pranimin e kërkesës së të kërkuarit ***** dhe urdhëron Z.V.RR.P.P .Durrës , për heqjen e sekuestro preventive mbi pasurinë e luajtshme dhe të pa luajtshme të dhënë me vendimin Nr. 436 datë 08.07.2015 e konkretisht:
- □□□□□□□ Pasuria Nr 2/228,vol 1 8,fq 75, ndodhur me adresë Lagja nr 18, Rr "A.Goga", ku është regjistruar një apartament me sip 65 m2, nr. dok. 5349 datë 08.05.2009, me vlerë 3.211.663 lekë.
- □□□□□□□ Pasuria nr 26/72-G2, vol 14, fq 222, me adresë Lagja nr 13, Plazh, garazhd, sipërfaqe e pasurisë 21.26 m2, dok.6682, datë 06.09.2005 vlera 1.900.000 lekë.
- □□□□□□□ Pasuria nr 26/72+110, vol 14, fq 231 me adresë në Lagjen nr .13, plazh, apartament sipërfaqe e pasurisë 106.0 m2, nr. dok. 03682, datë 09.06.2009, vlerë 1.900.000 lekë.
- □□□□□□□ Pasuria nr 27/168 NB - 47, vol 55, fq 195, me adresë në Lagjen nr 13, plazh Durrës, sipërfaqe e pasurisë 119.2 m2, ref 010387 nr. dok 10989 datë 28.210.2008, me vlerë të pasurisë 11.997.480 lekë në emër të shtetasit Nuri Rama.
- □□□□□□□ Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- □□□□□□□ Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda afatit ligjor në Gjykatën e Apelit Durrës.
- □□□□□□□ U shpall në Durrës më datë 16.02.2017.

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.